

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria “ALBAS” është rregjistruar pranë QKR me datë 01/03/2000, Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj aktualisht në Tiranë, , Rruga "Donika Kastrioti", Pallati 14, Ap. 4/D.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Shërbime në fushën e botimeve, libra shkollorë, libra dhe të gjitha llojet e botimeve të ndryshme, shtypshkrime duke përfshirë dhe punime speciale tipografike, të të gjitha llojeve. Importim, instalim dhe shitje linjash dhe impiantesh tipografike të të gjitha llojeve pjesë këmbimi për to, materiale ndihmëse dhe lende të pare për produktet tipografike. Import eksport të mallrave, leter të llojeve të ndryshme pa kufizim. bashkëpunimin dhe operimin me shoqëri vendase dhe të huaja, për operime reciproke si nënkontraktor i operatoreve në fushën e shtypshkrimeve, si dhe në aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë. Shit-blerje të pasurive të palujtshme të çfaredolloji dhe dhenie me qira të tyre, për interes të shoqërisë. Këshillime, konsulence, trajnime profesionale, kurse afatshkurter dhe afatgjate, në fushën e kërkimit, edukimit profesional dhe botimit shkencor, për punonjës arsimorë (parauniversitar dhe universitar), studente, specialiste të fushave të ndryshme të mesimdhënies dhe me gjere; gjithashtu shoqëria do të merret me shërbime si organizimin dhe ndërmjetësim për konferenca, takime, seminare, aktivitete me karakter artistik, kulturor, shkencor për botën akademike për llogari dhe interes të saj si dhe të tjerëve.

Administrator i shoqërisë është Znj.Rita Petri

Selia e shoqërisë është Rruga "Donika Kastrioti", Pallati 14, Ap. 4/D Tiranë.

Shoqëria është e regjistruar në Njësinë e Tatimit Paguesve Tiranë me NUIS: K31528037R.

Numri i punonjësve me dt 31.12.2021 është 33 dhe me dt.31.12.2020: 32

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në zbatim të Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) NR 2 të përmirësuar si dhe Ligjit Nr. 25/2018 “ Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorjës gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

“ALBAS” shpk

Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura ne periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabel të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabel është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel të mëposhtëme janë aplikuar për periudhën që fillon me 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes se transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit	2021	2020
Eur/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2 Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime ne kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arkëtueshme

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje në pagesa (mbi 360 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv .

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3.3 Aktive afat-gjata materiale

(I) NJOHJA DHE MATJA

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në “Ndërtim në proces” dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(III) AMORTIZIMI

“ALBAS” shpk

Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar të cdo pjese të aktivitet afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktiveve afat-gjatë në periudhën 2020, 2019 janë si më poshtë:

Kategoria	Metoda	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Aktivet e patrupëzuara	Lineare	15%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të gjitha aktivet e tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi.

(IV) Çrregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjate materiale crregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjate, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4 Zhvlerësimi

(I) AKTIVET FINANCIARE

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(II) AKTIVET JO-FINANCIARE

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe

“ALBAS” shpk

Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare te mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t’u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit.

4. Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2021, 2020 është si më poshtë :

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Llogari rrjedhese	65,095,694	74,877,314
Llogari ne lek	54,262,795	73,081,212
Llogari ne monedhe te huaj	10,832,899	1,796,102
Arka	5,112,583	4,728,517
Totali	70,208,276	79,605,830

5. Llogari te arketueshme tregtare

Llogarite e arketueshme tregtare me 31 Dhjetor 2021, 2020 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Kliente per tu arketuar	31,827,155	54,129,928
Totali	31,827,155	54,129,928

6. Llogari te arketushme nga palet e lidhura

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Llogarite e arketueshme nga palet e lidhura me 31 dhjetor 2021, 2020 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Dividende te paguar	14,198,271	7,971,254
Totali	14,198,271	7,971,254

7. Inventari

Inventari me 31 Dhjetor 2021, 2020 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mallra (libra)	116,460,854	120,557,660
Parapagime per inventar	680,679	598,031
Totali	117,141,533	121,155,691

8. Llogari te tjera te arketushme

Llogari te tjera te arketueshme analitikisht me 31 Dhjetor 2021, 2020 jane si vijon:

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Tatim fitimi	-	2,618,601
Paradhenie	2,604,988	1,116,814
Te tjera	104,040	104,040
Tvsh gjendje kreditore	7,854,284	1,693,086
Totali	10,563,312	5,532,541

9. Aktive financiare

Aktive financiare pjesemarrje me 31 dhjetor 2021, 2020 jane si vijon

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pjesemarrje ne shoqerine Deaprint	320,379,960	320,379,960
Totali	320,379,960	320,379,960

10. Aktivet afatgjata

Aktive afatgjata materiale me 31 Dhjetor 2021, 2020 paraqiten si me poshte:

	Toka	Investime neNdërtesa	Pajisje	Mjete transporti	Te tjera	Total
Kosto e vlerësuar						
Në 1 Janar 2021	0	12,329,842	0	53,952,403	26,835,974	93,118,219
Shtesa		963,167	0		2,391,690	3,354,857
Transferuar nga ndërtime në progres						0
Shitje						0
Rivleresime						0

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Kaluar ne aktive financiare					0	
Ne 31.12.2021	0	13,293,009	0	53,952,403	29,227,664	96,473,076
Amortizimi i grumbulluar						
Në 1 Janar 2021	0	2,767,856	0	32,964,090	17,958,668	53,690,614
Amortizimi i Vitit		589,158		4,186,162	2,192,013	6,967,333
Shitje						0
Rivlerësim						0
Ne 31.12.2021	0	3,357,014	0	37,150,252	20,150,681	60,657,947
Vlera Neto:	0	9,935,995	0	16,802,151	9,076,983	35,815,129

- Aktivitet afatgjata jo materiale

	Konc, Patenta Licenca, etj	Totali
Kosto		
Më 1 janar 2020	7,551,771	7,551,771
Shtesa		0
Më 1 janar 2021	7,551,771	7,551,771
Shtesa		0
Më 31 dhjetor 2021	7,551,771	7,551,771
Amortizimi i akumuluar		
Më 1 janar 2020	5,318,482	5,318,482
Shuma për vitin	1,076,205	1,076,205
Më 1 janar 2021	6,394,687	6,394,687
Shuma për vitin	725,736	725,736
Më 31 dhjetor 2021	7,120,423	7,120,423
Vlera e mbetur		
Më 31 dhjetor 2021	431,348	431,348

11. Te tjera llogari te arketueshme

Te tjera llogari te arketueshme me 31 dhjetor 2021, 2020 jane si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të drejta për tu arkëtuar nga proceset gjyqësore	30,179,396	30,038,234
Totali	30,179,396	30,038,234

12. Llogari te pagueshme tregtare

Llogari te pagueshme tregtare me 31 dhjetor 2021, 2020

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Furnitore	12,608,207	10,519,461
Totali	12,608,207	10,519,461

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

13. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore me 31 dhjetor 2021, 2020 jane si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatim ne burim per autoresi	4,459,210	3,750,755
Tatim fitimi	1,845,674	778,998
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	2,260,023	1,169,261
Totali	8,564,907	5,699,014

14. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime me 31 dhjetor 2021, 2020 janë përbërë si me poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Arketime ne advance	125,177	125,177
Totali	125,177	125,177

15. Kapitali I nenshkruar

Kapitali i shoqerise eshte 346,112,000 leke i zoteruar si me poshte perkatesisht per vitet 2021,2020:

Ortaku	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2021			Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2020		
	Kuotat	Vlere nominale	%	Kuotat	Vlere nominale	%
Rita Pietri	1	173,056,000	50%	1	173,056,000	50%
Driton Ajrulai	1	173,056,000	50%	1	173,056,000	50%
TOTALI		346,112,000	100%		346,112,000	100%

16. Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat nga aktiviteti i shrytezimit per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 , jane si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Te ardhura nga shitja punimeve sherbimeve	2,067,936	13,982,407
Te ardhura nga Shitja e mallrave	253,521,407	256,774,014
Te tjera	-	471,747
Totali	255,589,343	271,228,167

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme , sherbime dhe te tjera shpenzime

Ne kete ze paraqitet kostoja e mallrave, lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara qe lidhen me veprimtarine e shfrytzezimit. Lendet e para, materiale te konsumueshme dhe sherbime te tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Materiale lende e pare e konsumuar	94,416,285	124,471,375
	94,416,285	124,471,375

18. SHPENZIME TE PERSONELIT

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Pagat e personelit	52,436,945	42,672,680
Sigurimet shoqerore	5,636,211	5,022,575
	58,073,156	47,695,255

19. Te tjera shpenzime

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime te tjera		
Shpenzime energji elektrike dhe uje	3,016,829	2,044,579
Shpenzime te ndryshme, kancelari, publicitet	723,352	572,306
Shpenzime telefoni, interneti	951,582	1,295,650
Shpenzime qera	11,682,473	10,770,244
Sherbime nga te trete	2,232,418	12,846,765
Shpenzime autoresi	29,541,181	38,753,064
Mirembajtje	769,541	1,189,721
Shpenzime te tjera	18,038,644	11,597,320
Te tjera operative	5,534,160	1,174,866
Totali	72,490,180	80,244,515

20. SHPENZIME FINANCIARE

Analitikisht te ardhurat dhe shpenzimet financiare per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020 jane si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	377,267	327,282
Te ardhura te tjera		

“ALBAS” shpk
Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 Vlerat ne leke

Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit		
Shpenzime per interesa	351,217	28,664
TOTALI	26,050	298,618

21. TATIM MBI FITIMIN

Shoqëria ka aplikuar normën e tatim fitimit mbështetur në ligjin për të ardhurat Deklarimi i tatimit mbi fitimin për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2021, 31 Dhjetor 2020 është si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitim (humbje) te mbartura		-
Fitimi humbje e vitit ushtrimor	22,942,702	10,120,974
Shpenzime te pazbritshme	7,211,423	1,040,909
Fitimi i tatueshem	30,154,125	11,161,883
Shpenzime te tatimit mbi fitimin 15%	4,523,119	1,674,282
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	18,419,583	8,446,692

SHPENZIME TE PAZBRITSHME

Zëra shpenzimesh të panjohura

Te tjera te pazbritshme	7,211,423	1,040,909
Gjoha dhe penalite		
Total shpenzime te panjohura	7,211,423	1,040,909

22. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Ceshtje gjyqesore

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treat. Bazuar ne opinionin e drejtuesve te Shoqerise, konkluzioni perfundimtar ne lidhje me keto ceshtje nuk do te kete efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 Dhjetor 2021 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

23. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare